

## PROTOKOLLI

### PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ARTISTIK MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim: ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim: ASHAK), në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000, për vitet 2009-2011, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimtari të përbashkëta:

1. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërakademik. Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHSH (IGJL - QSA) dhe ASHAK (SGJL);
2. Enciklopedia shqiptare. Projekt i përbashkët i dy Akademive. ASHSH (IGJL - QSA) dhe ASHAK (SGJL); 2009 e në vazhdim;
3. Enciklopedia e artit shqiptar. Botim i përbashkët i ASHSH (SSHSHA, QSA) dhe ASHAK (SA), 2009;
4. Kërkime arkeologjike në Kosovë. *Përpilimi i Hartës arkeologjike, II. Gërmime arkeologjike në Rrafshin e Kosovës.* Projekt i përbashkët i Muzeut të Kosovës dhe ASHSH (SSHSHA, IA – QSA). 2009 e në vazhdim;
5. Veshjet popullore të Kosovës. *Volumi V.* Vazhdim i korpusit të veshjeve popullore. Projekt studimor dhe botim i Albumit përkatës i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe ASHSH (SSHSHA, IAKSA – QSA). 2009 e në vazhdim;
6. Fjalor me fjalë dhe me shprehje popullore. Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL - QSA) dhe ASHAK (Instituti Albanologjik i Prishtinës). 2009 e në vazhdim;
7. Fjalor shpjegues i informatikës. Hartimi dhe botimi i Fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSHNT, IGJL – QSA, Fakulteti i teknologjive të Informacionit - UPT), 2009 e në vazhdim;
8. Fjalor shpjegues i termave të botanikës. Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët ASHAK (SShN) dhe ASHSH (SSHNT, IGJL – QSA, Dept. i Bioteknologjisë dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës – FSHN, UT), 2009 e në vazhdim;

- 9. Konferencë shkencore “Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë në kuadrin e integrimeve rajonale e më gjerë”, ASHSH dhe ASHAK. Tiranë, 2009;**
- 10. Konferencë shkencore “Çështje të diakronisë së shqipes”, ASHAK (SGJL), në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, IGJL-QSA), Prishtinë, 2009;**
- 11. Konferencë shkencore: “Historia e letërsisë shqipe”, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, IGJL - QSA). Prishtinë 2009;**
- 12. Konferencë shkencore: “Studime albanistike”, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2010;**
- 13. Konferencë “Gjendja aktuale dhe prioritetet për reformimin e shërbimit shëndetësor në Kosovë dhe Shqipëri”, ASHSH (SSHNT Fakulteti i Mjekësise, QSUT) dhe ASHAK (SSHN), Tiranë 2010.**
- 14. Konferencë “Zhvillimi i Teknologjive të Informacionit: Teoria dhe Teknologjia” ASHSH (SSHNT; Fakulteti i Teknologjive së Informacionit - UPT) dhe ASHAK (SSHN), Tiranë, 2010;**
- 15. “Konferencë Shkencore e Algebrës dhe e Analizës Funksionale” organizuar nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, ASHSH (SSHNT) dhe ASHAK (SSHN), Elbasan, 2010.**
- 16. Konferencë për veprën shkencore të Selman Rizës, ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSHSHA, QSA, UT) Tiranë, 2009;**
- 17. Sesion shkencor për “Gjendjen e terminologjisë shqipe dhe perspektivat e zhvillimit të saj”, ASHSH (SSHSHA, IGJL – QSA) dhe ASHAK (SGJL). Tiranë, 2009;**
- 18. Sesion shkencor “Jeta dhe vepra shkencore e profesor Ramadan Sokolit”. ASHAK (Bartës IAP-i dhe institucionet e tjera të interesuara) dhe ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë, Qershori 2009;**
- 19. Sesion shkencor: “90-vjetori i kryengritjeve shqiptare të vitit 1919”. ASHAK (Bartës IAP-i dhe institucionet e tjera të interesuara) dhe ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë, nëntor 2009;**
- 20. Tryezë shkencore “Për kritikën letrare”, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Tiranë 2010;**
- 21. “Shënim i 100 –vjetorit të Normales së Elbasanit dhe 100-vjetori i Kongresit të Elbasanit”, ASHSH (SSHSHA, QSA) në bashkëpunim me ASHAK (SSHSH dhe SGJL) Elbasan 2009;**
- 22. “Shënim i 130-vjetorit të lindjes së Milan Shuflay-it”, ASHAK (IH) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2009;**
- 23. Projekti “Vlerësimi i rrezikut sizmik të Kosovës”, në këtë kuadër për hartimin e Katalogut të tërmiteve të Kosovës. ASHSH (SSHNT, Institut i Gjeoshkencave – UPT). dhe ASHAK (Instituti i Sizmologjisë), 2009-2011.**
- 24. Projekti: “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë”, ASHAK (SSHN) në bashkëpunim me ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT), 2009 e në vazhdim;**

**25.** Projekt “**Studim pilot për menaxhimin e ekosistemeve natyrore me Status Specifik të Mbrojtur të dy zonave me rëndësi në Shqipëri dhe Kosovë**”. Hartim i një udhëzuesi mjedisore. ASHSH (SSHN, FSHN - UT; UBT, MMAU) dhe ASHAK (SSHN), 2009 e në vazhdim;

**26.** Projekt “**Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri**” Hartimi i një manuali. ASHSH (SSHNT; FSHN - UT; UBT; QTTB, Vlorë, MBUMK) dhe ASHAK (SSHN), 2009 e në vazhdim;

**27.** Shkëmbime informacionesh në fushë të hidrometeorologjisë . ASHSH (SSHNT, INEUM) dhe ASHAK. 2009 e në vazhdim.

**28.** Hartimi i monografisë “**Bazat e Meteorologjisë**” ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT) dhe ASHAK (SSHN), 2009 e në vazhdim;

**29.** Ekspeditë e përbashkët për mbledhjen e lëndës folklorike, etnologjike gjuhësore në trevat e paeksploruara sa duhet. ASHAK (IAP-i) dhe ASHSH (SSHN, QSA), 2009 e në vazhdim;

**30.** Eksposítë e përbashkët e R. Ferrit, T. Emrës dhe Gj. Gjokajt (krijimtaria më e re), ASHAK (Sekcioni i Arteve) në bashkëpunim me ASHSH (Galeria Kombëtare e Arteve), Tiranë, 2009;

**31.** Promovime veprash shkencore. ASHSH dhe ASHAK. 2009 e në vazhdim;

**32.** Mundësi për bashkëpunime të reja si rezultat i takimeve bilaterale në vazhdim. ASHSH dhe ASHAK.

**33.** Studime mbi trashëgiminë kulturore silvo - pastorale në përdorimin tradicional te territorit. ASHSH (SSHNT, UBT, FSHN-UT)dhe ASHAK (SSHN). 2010 e ne vazhdim;

**34.** Ekspedita të përbashkëta ndërdisiplinore, ASHSH dhe ASHAK. 2009 e në vazhdim;

**35.** Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore. ASHSH dhe ASHAK 2009 e në vazhdim;

**36.** Ligjërata të ndërsjella të akademikëve. ASHSH dhe ASHAK.

Për secilën prej veprimitarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimitarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.


Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të burimeve financiare.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.


Nënshkruar në Tiranë, më 4 maj 2009, në dy kopje, me përbajtje  
dhe vlerë të njëjtë.

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE  
DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

PËR AKADEMINË  
E SHKENCAVE  
TË SHQIPËRISË

  
Akademik Prof. Dr. Besim BOKSHI



  
Akademik Prof. Dr. Lludar BEQIRAJ

